



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 05/2025

I Mbajtur në takimin e V-të të rregullt të KPF-së me datën 28.05.2025, në sallën e takimeve në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e V-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për zgjerimin e varrezave në Fshatin Cërnillë;
5. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Sojevës;
6. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shtatores të Dëshmorit “Zejnullah Zejna” në Fshatin Sojevë;
7. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Talinoc i Muhaxherëve;
8. Propozim – Vendim për ndryshimin e destinimit të njësisë kadastrale 690-6 Z.K. Talinoc i Jerlive;
9. Propozim – Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes;
10. Propozim - Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 2342-1 Z.K.Rahovicë, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 2262-0 Z.K. Rahovicë, pronë e Komunës së Ferizajt;
11. Propozim - Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm-Publik të ngastrave kadastrale; 1059-7 dhe 1059-8 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Kombinatit Bujqësor Industrial me qëllim të zgjerimit të varrezave të Fshatit Prelez i Jerlive;

12. Propozim - Vendim për këmbimin e ngastrës kadastrale 2435- 1 dhe 2435-2 Z.K. Ferizaj, prona private, me pjesën e ngastrës kadastrale 180-10 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës Ferizajt;
13. Propozim – Vendim për Miratimin e Plotësim Ndryshimit të Vendimit 01.Nr.30, të datës 28.03.2025, për Bartjen e Mjeteve nga Viti 2024 në Vitin 2025;
14. Propozim – Vendim për Plotësim Ndryshimin e Vendimit me Nr.01.Nr. 96 të datës 27.09.2024;
15. Pyetje dhe kërkesa dhe
16. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe e lexoi rendin e ditës së lartcekur, dhe pyeti nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës.

Arian Imeri theksoi se emrat që janë kontestues rreth listës rezervë duhet të rregullohen, Arbër Bytyqi theksoi që e kanë ba verifikimin nga ministria dhe se kam gati po nëse pranoi unë e përgatisë për seancë, nëse e futni në rend të ditës.

Kryesuesi theksoi se e kam një propozim që është Propozim - Vendim për shpallje interes i përgjithshëm të ngastrës kadastrale 3523-1 me qellim të këmbimit me 188-1 është kërkesë e palës ju ka marre për rrugë, duhet me ja kompenzu.

Kryesuesi pyeti a ka tjetër, nëse ska kush është për miratimin me këto dy plotësime dhe kaloi me 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Vazhdojmë me rendin e ditës, miratimi i procesverbalit, fjalën e morri Mimoza Pajaziti e cila theksoi se i ka humb kuptimi pak pikës te shëndetësia, kom thanë; u kanë mirë me kanë edhe policia dhe zjarrfikësit se unë se kom anulu, po kom thanë për të gjithë mu dok aty qe kom dal keq po d.m.th të përmirësohet.

Kush është për miratimin me këtë vërejtje të Mimosës dhe kaloi me 8 vota për, 0 kundër.

Kryesuesi - Vazhdojmë me piken e 4-të, dhe pasi spati të interesuar për diskutim kaloi me 8 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5-të edhe këtu spati të interesuar për diskutim dhe kaloi me 8 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 6-të dhe kjo kaloi me 8 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 7-të të rendit të ditës dhe këtu spati të interesuar për diskutim dhe kaloi me 8 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 8-të dhe kaloi me 8 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 9-të dhe fjalën e mori Arian Imeri i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se unë kam një kërkesë edhe nga një djalë tjetër që është kanë ushtar, kish pas problem mi gjetë disa dokumenta, është rast i njëjt dhe nëse i plotëson dokumentet atëherë do ta kemi në seancë edhe atë si shtesë të kësaj liste.

Pasi spati të interesuar tjerë për diskutim kaloi me 9 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 10-të dhe kaloi me 9 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 11-të dhe kaloi me 9 vota për,

Kryesuesi e lexoi pikën e 12-të, Arbër Bytyqi theksoi se ky është vlerësimi nga ministria dhe pritet të dal në kuvend si vendim përfundimtar dhe pasi spati të interesuar për diskutim kaloi me 8 vota për, 1 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 13-të dhe spati të interesuar për diskutim, kaloi me 9 vota për,

Kryesuesi e lexoi pikën e 14-të dhe theksoi se këtu i kemi dy kërkesa, dy ankesa dy lagje në mes veti në Komogllavë kundërshtohen, na e kemi marrë një vendim dhe kemi leju një ndërtim për objekt për të pame, kemi tash kundërshtime që ka pas varreza, realisht kjo kërkesë nuk është e arsyshme pasi aty u investu shumë mbi 60 mijë euro dhe objekti pa parking nuk vyn, unë kam një kërkesë që sot të shkohet në vendin e ngjarjes nga një përfaqësues i grupeve të shkojmë sot në vend të ngjarjes dhe të shikojmë, ne pe qesim në kuvend këtë pikë, po njëkohësisht po shkojmë atje e vlerësojmë gjendjen në teren dhe vendosim në kuvend. Pasi kjo kërkesë për 3 ari si nxen as 5 kerre, dhe u vendos që të shkohet në vendngjarje, kjo pikë kaloi në kuvend me 9 vota për.

Kryesuesi e lexoi piken e 15-të për shpalljen interes i përgjithshëm 3523-1 Z.K. Ferizaj që të këmbehet me 188-1 Z.K. Ferizaj, pasi spati të interesuar për këtë pikë, kaloi me 9 vota për.

Po ashtu Arbër Bytyqi theksoi se duhet ta qesim plotësim ndryshimin e vendimit për adresa që të plotësohet pasi ministria ka kërku që të bëhen disa plotësime dhe mbeti që ta përgatisë në detaje për kuvend dhe kaloi me 9 vota.

Në të ndryshme, Flamur Istrefi kërkojë që tek pika e 15-të të sjellni materialin më të detajuar pasi kështu s'mund të vlerësohet.

Kryesuesi theksoi se këtë mbledhje e shpall të mbyllur.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

